VENDIM
Nr.47, datë 18.4.2008

PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË PROJEKSION SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 15 të "Rregullores për procedurat e licencimit", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.14, datë 4.2.2008 "Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike me nr.40, seria PV06P", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.4.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Projeksion Energji" sh.a. për ndryshimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike me nr.40, seria PV06P, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.76, datë 7.11.2006, shoqërisë "Projeksion" sh.p.k., dhe konstatoi paraqitjen e plotë nga shoqëria "Projeksion Energji" sh.a., të dokumentacionit të kërkuar nga ERE,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë "Projeksion Energji" sh.a. për ndryshimin e licencës nr.40, seria PV06P, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.76, datë 7.11.2006 shoqërisë "Projeksion" sh.p.k.
2. Në licencën me nr.40, seria PV06P, në pjesët ku përcaktohet subjekti të cilit i jepet licenca, ndryshohet subjekti "Projeksion" sh.p.k. dhe vendoset emërtimi i subjektit "Projeksion Energji" sh.a., si dhe të dhënat e kësaj shoqërie lidhur me kodin fiskal dhe certifikatën e regjistrimit.
3. Kudo ku në licencë përcaktohet "Projeksion" sh.p.k. si mbajtës i licencës, pjesët e licencës shfuqizohen dhe hyjnë në fuqi ndryshimet sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Në pjesët e licencës së dhënë shoqërisë "Projeksion" sh.p.k., ku përcaktohet data e hyrjes në fuqi të licencës, në vazhdim të numrit të vendimit të përcaktuar në licencën nr.40, seria PV06P, shënohen edhe ndryshimet e këtij vendimi si pasojë e vendimmarrjes së Bordit të Komisionerëve të ERE-s me datë 18.4.2008.
5. Shoqërisë "Projeksion Energji" sh.a. t'i lëshohet licenca me përmbajtjen e ndryshuar siç përcaktohet në këtë vendim.
6. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë "Projeksion Energji" sh.a. dhe "Projeksion" sh.p.k. për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Napravishta